



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
***Kuvendi - Skupština – Assembly***

---

**Legjislatura VI**  
**Sesioni pranveror**

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike  
Mbledhja nr. 20  
Prishtinë, më 05 qershor 2018, në orën 10:00  
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-302

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Driton Selmanaj, Mërgim Lushtaku, Ahmet Isufi, Andin Hoti, Shqipe Pantina, Avdullah Hoti, Albert Kinolli, Ali Lajçi, Zafir Berisha dhe Verica Çeraniq.

**Mungoi:** Faton Topalli.

**Stafi mbështetës:** Mehmet Simnica dhe Ajet Avdullahu.

**Pjesëmarrësit tjerë:** Ramadan Cariqi, Isak Rakovica, Muhamet Musliu nga Hortikultura SH.A; Vlora Spanca, Enver Buqolli nga ZKA-ja; Ismail Shabani nga Kosova Press; Rabije Hyseni nga Zyra për Marrëdhënie me Publikun; Aurora Buqaj, Adelina Hasani nga KDI dhe Donika Osmani nga Ekonomia Oline.

**Mbledhjen e kryesoi:** Driton Selmanaj, kryetar i komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 22.05.2018;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve për raportin e Auditimit për PVF-të e Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2017;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve për raportin e Auditimit për PVF-të e Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2017;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve për raportin e Auditimit të Përformancës për “Menaxhimi dhe shfrytëzueshmëria e aplikacionit e-Pasuria”;
6. Shqyrtimi i raportit të auditimit për PVF-të e SH.A. Hortikultura për vitin 2017;
7. Të ndryshme.

*Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.*

**1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

**2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes të mbajtur më 22.05.2018;**

*Përfundimi*

*Procesverbalet e mbledhjes, të mbajtur më 22.05.2018, u miratuan pa vërejtje.*

**3. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve për raportin e Auditimit për PVF-të e Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2017**

Kryetari paraqiti rekomandimin për AAC-në si vijon: AAC-ja duhet të hartojë planin e veprimit për të gjeturat e auditorit, duke caktuar personat përgjegjës dhe afatet kohore për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e auditorit të jashtëm për vitin 2017. Për këtë, brenda një muaji, ta njoftojë KMFP-në, në veçanti: 1. Të kategorizohen shpenzimet e fondeve, sipas nënkategorive ekonomike, si: udhëtimet zyrtare, qiraja e objektit dhe shpenzimet e telefonisë mobile. 2. Të bëhet një zgjidhje afatgjatë, sa i përket auditimit të brendshëm, si dhe të funksionalizohet Komiteti i Auditimit të Brendshëm.

*Përfundimi*

*KMFP vendosi që raporti i Auditimit për PVF për Autoritetin e Aviacionit Civil për vitin 2017, të mos adresohet për në Seancë Plenare, rekomandimet i dërgohen AAC-së.*

**4. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve për raportin e Auditimit për PVF-të e Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2017**

Kryetari paraqiti rekomandimin për OSHP si vijon: OSHP duhet të hartojë planin e veprimit për të gjeturat e auditorit, duke caktuar personat përgjegjës dhe afatet kohore për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e auditorit të jashtëm për vitin 2017. Për këtë, brenda një muaji, ta njoftojë KMFP-në dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit.

*Përfundimi*

*KMFP vendosi që raporti i Auditimit për PVF për Organin Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2017, të mos adresohet për në Seancë Plenare, rekomandimet i dërgohen OSHP-së.*

**5. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve për raportin e Auditimit të Performcës për “Menaxhimi dhe shfrytëzueshmëria e aplikacionit e-Pasuria”**

Kryetari paraqiti rekomandimin për e-Pasurisë, si vijon: MAP duhet të hartojë planin e veprimit për të gjeturat e auditorit, duke caktuar personat përgjegjës dhe afatet kohore për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e auditorit të jashtëm, për Raportin e auditimit të performancës “Menaxhimi dhe shfrytëzueshmëria e aplikacionit e-Pasuria“. Për këtë, brenda një muaji, ta njoftojë KMFP-në dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit.

### *Përfundimi*

*KMFP, vendosi që raporti i Auditimit për e-Pasurinë, të mos adresohet për në Seancë Plenare, rekomandimi i dërgohen MAP-it.*

## **6. Shqyrtimi i raportit të auditimit për PVF-të e SH.A. Hortikultura për vitin 2017**

**Kryetari** njoftoi se në cilësinë e raportuesit për shqyrtimin e raportit të Auditimit për PVF-të e SH.A. Hortikultura për vitin 2017 është deputeti Ali Lajçi, fillimisht ftoi përfaqësuesit e Zyrës Kombëtare ta prezantojë raportin dhe të gjeturat nga raporti.

**Vlora Spanca** paraqiti në pika të shkurta të gjeturat në auditimin e SH.A. Hortikultura për vitin 2017. Hortikultura kishte prezantuar edhe planifikimin e buxhetit për vitin 2017. Të hyrat e realizuara janë 59 % më pak se shuma e planifikuar. Kjo për shkak të kërkesës së ulët për shërbime nga Komuna e Prishtinës. Megjithatë, ndërmarrja një gjë të tillë nuk e kishte mbështetur me një rishikimin të buxhetit ku do të refleктоhej në planin e të hyrave, si dhe të shpenzimeve për të siguruar menaxhimin e duhur të ndërmarrjes; Sipas nenit 9 të statutit të Ndërmarrjes, çështjet e caktuara të cilat nuk janë të përfshira në statut mund të rregullohen me rregullore të brendshme. Aktet e përgjithshme me propozim të KE-së miratohen nga ana e BD. Ndërmarrja nuk kishte nxjerrë ndonjë rregullore, ku do të përcaktoheshin rregullat dhe kushtet për menaxhimin e të hyrave; dhe Në kontratën Kornizë në mes të Komunës së Prishtinës dhe Hortikulturës, për shërbime për mirëmbajtjen e sipërfaqeve gjelbëruese, vlera totale indikative e kontratës ishte 799,999€ devijimi i lejuar plus-minus 30%. Ndërmarrja në muajin korrik, nuk kishte arritur të faturonte për shërbimet e afruar në vlerë prej 14,531€ për shkak se vlera e kontratës dhe devijimi i lejuar 30% ishin përmbushur. Kjo ka ndodhur si pasojë e një mos vlerësimi real të vlerës së ofertës për këto shërbime. Në fushën e shpenzimeve për pagat dhe menaxhimin e personelit janë evidentuar disa mangësi duke përfshirë, kontratat me afate të caktuara, kanë të përcaktuara afatin kohor të marrëdhënies së punës. Gjatë testeve tona kemi vërejtur se kontratat e katër zyrtarëve të lartë të ndërmarrjes: kryeshefit Ekzekutiv, zyrtarit kryesor Financiar dhe të hesarit, Sekretarit Korporativ dhe Auditorit të Brendshëm nga viti 2015 u kishte skaduar kontrata dhe ata vazhdojnë të ushtrojnë punën e tyre. Mos ripërtërija e kontratave të këtyre zyrtarëve ka ndodhur për shkak të mungesës së Bordit të Drejtorëve.

**Shqipe Pantina** theksoj se për këtë raportim para Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike duhet të jetë Bordi i Drejtorëve dhe aksionari (Komuna e Prishtinës) sepse ata janë organi menaxhues. Po ashtu pyeti se Pasqyrat Financiare a i përgatitni ju apo Drejtoria e Shërbimeve Publike në Komunë, se nëse i përgatitni ju ka hapësirë për vërejtje për ju dhe stafin e juaj?

**Albert Kinolli** pyeti duke u bazuar në pikat 4 dhe 6.6 në raportin e auditimit. Hortikultura nuk ka bërë hapa konkret në drejtim të vendosjes së sistemit për menaxhimin e rreziqeve, nuk kishte të hartuar regjistrin e rreziqeve me qëllim të identifikimit dhe zvogëlimit të tyre në nivel të pranueshëm, pse ka

ndodhur kjo më intereson komenti juaj. Dhe te pika 6.6, Hortikultura nuk kishte arritur të përmbush me kohë obligimet ndaj furnitorit në vlerë prej 2,590€. Për shkak të vonesës në pagesë tre muaj, furnitori kishte aplikuar procedurën përmbartimore me qëllim të inkasimit të mjeteve, më intereson ta di pse ka ndodhur kjo?

**Zafir Berisha** tha se duke u bazuar ne raportin e auditimit për Hortikulturën ka shumë parregullsi duke filluar nga menaxhimi i financave dhe kontrollit, pagat dhe menaxhimi i personelit, shpenzimet përmes prokurimit, obligimet. Unë mendoj që për këtë raportim duhet të jetë edhe aksionari, siç është në këtë rast Komuna e Prishtinës për të dhënë sqarime më menaxhimin e kësaj ndërmarrje sepse flitet për shuma shumë të mëdha siç janë afër 800,000 euro.

**Ahmet Isufi** tha se sa i përket këtij raporti mendoj se është dashtë të jetë dikush nga Komuna e Prishtinës në cilësi të aksionarit, më mirë kishte me qenë që ndërmarrja ta kishte bordin menaxhues si dhe të përgjigjet për këto të gjetura. Mendoj se duhet një takim me komunën që të kërkohet që të iniciohet kërkesa për zgjedhjen e bordi drejtues sa më parë.

**Isak Rakovica**, duke u përgjigjur në pyetjet e deputeteve, veçoi problemin e mos zgjedhjes së bordit të drejtorëve ku është e vështirë të ketë suksese një kompani pa bord, dhe problemi tjetër është amortizimi i mjeteve në nuk kemi një buxhet për mirëmbajtjen e mjeteve të punës. Suksesi i kompanisë tonë është vetë kultivimi i fidanëve luleve dhe mirëmbajtja e qytetit.

### *Përfundim*

*KMFP vendosi që në njërin nga mbledhjet e radhës ta ftojë kryetarin e Komunës së Prishtinës për të arsyetuar raportin e SH.A. Hortikultura për vitin 2017, në mungesë të Bordit të Drejtorëve.*

## **7. Të ndryshme.**

Kryetari, theksoi se një numër i raporteve janë në pritje për shqyrtim andaj propozoi që në mbledhjen e radhës për të martën, më 12.06.2018, të shqyrtohen: Raporti vjetor për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike në sektorin publik në Kosovë, si dhe raporti i auditimit për Raportin e Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Kompanisë Regjionale të Ujitjes Drini i Bardhë SH.A. Pejë për vitin 2017.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

**E përgatiti:**  
**Stafi mbështetës i komisionit.**

**Kryetari i komisionit,**  

---

**Driton Selmanaj**